


Bashkërisht kundër Mobing-ut në shkollë ausgespielt

Ç'ËSHTË MOBING-U?


Një person është nën mobing nëse për një kohë të gjatë në mënyrë sistematike dhe të përsëritshme bie pre e veprimeve negative nga një apo më shumë persona.



SHENJAT E EPISODEVE TË MOBING-UT

- > Personi i atakuar (rrallë disa) është nën shtrëngesë.
- > Sulmet e drejtuara ndaj personave të caktuar janë sistematike dhe përsëriten.
- > Sulmet shpesh zgjasin për një kohë të gjatë (gjysmë viti apo më gjatë).
- > Personi që ndodhet nën mobing ka shumë pak mundësi që të largohet me forca të veta nga kjo situatë.
- > «Qëllimi» i sulmeve është shpesh përjashtimi nga bashkësia (punë, klasë)

Shumë nga episodet e veçanta janë tepër subtile dhe jo gjithherë mund të njihen qartë si sulme. Mobing-u është një mostër që për shkak të këtyre veprimeve të shumta negative formohet me kohë.



FORMAT E MOBING-UT

Mobing-u mund të ndodhë gjithkund: gjatë rrugës për në shkollë, në pauzë, në klasë, në stacionin e autobusit, në kthinat për veshje, përmes rrugës elektronike. Ne dallojmë paraqitje të formave direkte dhe indirekte të mobing-ut:

FORMAT DIREKTE

- > Trupore: p.sh. t'i shkaktohet dikujt dhimbje, mbajtja e dikujt pa vullnetin e tij
- > Verbale (me gojë): p.sh. përqeshja
- > Kundër pasurisë: p.sh. dëmtimi i biçikletës
- > Kërcënimet: p.sh. zërja e pusisë në rrugën për në shkollë dhe shantazhi për para.

FORMAT INDIREKTE, SUBTILE

- > Gjestet/mimika/gjuha trupore: p.sh. perëndimi (rrotullimi) i syve
- > Përdorimi i tonit: p.sh. përhëndetje me përzemërsi të tepruar.
- > Përgojimi (përhapja e fjalëve): p.sh. vërja në qarkullim i gjërave të pavërteta.
- > Rrëmbimi: p.sh. marrja e shoqes më të mirë
- > Kufizimi: p.sh. gjatë punës në grup apo sport.
- > Injorimi, mospërfillja
- > E-mobing-u: p.sh. përçmimi me anë të e-mailit, SMS

PARAKUSHTET E NEVOJSHME PËR MOBING

- > Së paku një fëmijë nga grupi të jetë i gatshëm për agresion (keqbërës për mobing).
- > Të ketë fëmijë që bashkëpunojnë, por që vetë nuk ndërmarrin iniciativë (qëndrimi prapa keqbërësit, roli përforcues)
- > Fëmijët të cilët nuk janë direkt pjesëmarrës të mobing-ut, por që në të vërtetë asgjë nuk ndërmarrin për t'i ndihmuar viktimës (pasivët).
- > Të rriturit që nuk shohin gjë, nuk dëgjojnë, janë të pasigurt, shikojnë anash, kanë frikë.

Mobing-u është një fenomen grupor, është më shumë se sa një zënkë fjalësh në mes të keqbërësit dhe viktimës.


UDHËZIMET DHE PASOJAT

SINJALET PARALAJMËRUESE NGA VIKTIMAT E MOBING-UT PASOJAT E MUNDSHME PËR VIKTIMËN

- > Frika për t'i ra rrugës për në shkollë
 - > Të rënit e suksesit
 - > Lëndimet, shenjat me mavijosje në trup
 - > Gjërat e humbura / të dëmtuara
 - > Dhimbje koke/barku
 - > Mungesa e apetitit, pagjumësia, lodhja
 - > Frikësimi, zhvleftësimi i vetës
 - > Gjithnjë ma pak shokë e shoqe
 - > Frika nga shkolla.
- vetëvlerësimi i ulët, tërheqje në botën e brendshme, qëndrim themelor i tij është mosbesimi ndaj njerëzve të tjerë, fërkime depresive dhe në raste ekstreme: vetëvrasja.
- PËR KEQBËRËSIN/ËN**
sjellje e mëtutjeshme agresive dhe thyerje e normave, kufizimi i repertorit të mirësjelljeve, lidhja me moshatarët e tjerë agresiv, e më vonë delikuenca.

ÇKA MUND TË BËJNË PRINDËRIT SI MASË PARANDALUESE?

- > Nëse fëmija flet për shkollën dëgjoni atë me vëmendje dhe merreni seriozisht.
- > Forcojani fëmijës vetëbesimin, lavdëroni atë dhe përkrahni sukseset e tij edhe në lëmin jashtë shkollor.
- > Ndhimoheni atë gjatë krijimit të kontakteve dhe mirëmbajtjes së tyre jashtë shkollës.
- > Kujdesuni për biseda me shkëmbim të singertë dhe me besim të plotë, mundohuni të praktikoni sjellje konstruktive në rast konflikti.
- > Kujdesuni që të keni kontakt me prindërit e tjerë.
- > Kujdesuni për kontaktet me mësuesit, shfrytëzoni mbremjet për prindër dhe takimet për biseda me mësuesit. Mos pyetni vetëm për notat, por edhe për atë se a është fëmija i juaj i integruar mirë në klasë.



UDHËZIME PËR PRINDËRIT E VIKTIMAVE NGA MOBING-U

- > Bisedoni me fëmijën për mobing-un /maltretimet dhe i jepni atij kurajë që të bisedojë për te. Akceptoni ndjenjat e fëmijës (zemërimin, mllëfin, turpin).
- > Nëse fëmija nuk do të flas lidhur me këtë mos nguron t'i pyesni shokët dhe shoqet e klasës apo prindërit me të cilët shoqëroheni: fëmija juaj ka nevojë për mbrojtjen tuaj.
- > Kërkoni nga mësuesit një bisedë. E përgatitni bisedën me mësuesit hollësisht. Më parë mendohuni mirë se çka kërkoni (pritni) nga mësuesi dhe nga shkolla.
- > Përshkruani objektivistisht atë që ka ndodhur. Në asnjë mënyrë mos u merrni me atë se kush është fajtor. Mësuesit dhe mësueset normalisht nuk mund të bëjnë gjë.
- > Zhvilloni së bashku me mësuesit një strategji konkrete.
- > Rishqyrtoni se a kanë pru këto strategji deri te sukcesi i dëshiruar.
- > Nëse asgjë nuk ndihmon drejtohuni drejtorisë së shkollës. Shkolla e ka për detyrë të përkujdeset për atë që fëmija juaj të ndjehet mirë.
- > Sipas nevojës konsultohuni me një këshillimore eksterne të specializuar.

ÇKA NUK NDIHMON

- > Nëse e fajësoni fëmijën tuaj
- > Nëse bisedoni me prindërit e keqbërësit/ës që nuk i njihni mirë. Shumica e prindërve e mbrojnë fëmijën e tyre dhe miratojnë në këtë mënyrë sjelljen e tij agresive. Edhe nëse ata e dënojnë fëmijën e tyre, në të vërtetë për viktimën do të ketë vetëm ndikim negativ.
- > Nëse bisedoni me keqbërësit/et që nuk i njihni mirë. Kjo i tregon atij që bënë mobing se fëmija i juaj nuk mund të mbrohet vetë. Me këtë e dobësoni pozitën e fëmijës suaj.
- > Nëse e merrni me veti fëmijën në bisedën e parë që keni me mësuesit. Nga se pa marrë parasysh se çfarë thotë mësuesi, kjo bisedë mund të jetë për fëmijën si ngarkesë dhe mund ta forcojë te ai ndjenjën e fajit.

UDHËZIME PËR PRINDËRIT E KEQBËRËSVE QË USHTROJNË MOBING

Tendenca për ta mbrojtur fëmijën e vet pa i parë mirë gjërat është e madhe, por që fare nuk ndihmon. Si rregull themelore vlen gjithmonë: të bëhet ndarja e personit nga sjelljet e tij! Fëmija të respektohet si person, por sjelljet e tij qartë e kuptueshëm të emërohen e të mos lejohen.

- > Bisedoni me fëmijën se çfarë ka ndodhur dhe përpikuni të gjeni arsytet që e kanë shtyrë të silllet ashtu.
- > Shmanguni nga ajo që t'i leni dikujt fajin
- > Tregoni qartë kufirin, aksionet e mobing-ut nuk guxojnë të tolerohen.
- > Emëroni konsekuencat (çka e pret) nëse sjelljet negative mbesin (nuk përmirësohen).
- > Ofroni atij ndihmë për t'i ndryshuar sjelljet.
- > I tregoni atij qartë që jeni në kontakt me mësuesit dhe se jeni duke shkëmbyer me ta lidhur me sjelljet e tij.
- > Mos merrni kontakt me viktimën respektivist me prindërit e tij për t'u mbrojtur apo shfajësuar.
- > Sipas nevojës këshillohuni me një këshillimore eksterne: Këshillimorja për Edukim, psikologun/ën e shkollës, një terapeut/e për fëmijë apo për të rinjtë, nga se fëmija i juaj ka nevojë për ndihmë që të mund t'i ndryshojë sjelljet e padëshiruara.

PËR LEXIM TË MËTUTJESHËM

- > J. Eckardt, Mobbing bei Kindern, Urania Verlag, 2006
- > D. Krowatschek, Mobbing erfolgreich beenden, AOL Verlag, 2006

FAQE INTERNETI

- > www.mobbing-info.ch
- > www.seitenstark.de/mobbing-schluss-damit
- > www.schueler-mobbing.de

TË KËRKOSH NDIHMË

- > Berner Gesundheit (Shëndetësia e Bern it), 031 370 70 70, www.bernergesundheit.ch
- > Pädagogische Hochschule (Shkolla e Lartë Pedagogjike), 031 309 27 11, www.weiterbildung.phbern.ch
- > Erziehungsberatung des Kantons Bern (Këshillimorja për Edukim), 031 633 41 41, www.erz.be.ch/erziehungsberatung
- > Universität Bern, Alsaker Gruppe für Prävention (Universiteti i Bern-it, Grupi Alsaker për Parandalim), www.praevention-alsaker.unibe.ch

Burimet:

- > F. Alsaker, «Qualgeister und ihre Opfer», Huber Verlag, 2003
- > D. Olweus, «Gewalt in Schulen», Huber Verlag, 1995
- > «sonst bist du dran», Aktion Kinder- & Jugendschutz e.V., www.schueler-mobbing.de